

Marrëveshje për mbrojtjen e të dhënave personale

Në mënyrë që të llogariten Benefits sipas Benefit Program, myWorld Albania Shpk , një shoqëri e regjistruar në Bulevardi Bajram Curri, Galeria ETC Business Centre, Kati i 13-të, 1000 Tiranë, Shqipëri mbledh dhe përpunon të dhënat personale të Anëtarit, veçanërisht emrin dhe mbiemrin e tij, titullin, gjininë, datën e lindjes, adresën e postës elektronike/email, adresën postare, koordinatat e adresës (gjerësia dhe gjatësia), numrin/at i/e telefonit , numrin/at i/e faksit, ID-në e Anëtarit, detajet e llogarisë bankare (banka, IBAN, SWIFT dhe mbajtësi i llogarisë) si dhe informacionin rreth zakoneve të shit-blerjeve dhe blerjes së Anëtarëve (data, vendndodhja dhe koha e blerjes, shuma e blerjes, valuta, informacioni i shportës së blerjes, sektori, lloji i blerjes (*online, offline*,, mesazhet; llogaria kyç, me myWorld Card. Kur përpunohen të dhënat e sipërpërmendura, myWorld Albania Shpk , një shoqëri e regjistruar në Bulevardi Bajram Curri, Galeria ETC Business Centre, Kati i 13-të, 1000 Tiranë, Shqipëri mund të përdorë gjithashtu si përpunues të të dhënave myWorld 360 AG (Grazbachgasse 87-93, 8010 Graz, Austri).

Anëtari nëpërmjet këtij akti jep pëlqimin e tij – nga i cili mund të heqë dorë në çdo kohë - që myWorld Albania Shpk , një shoqëri e regjistruar në Rr."Sami Frasheri", Pallati i Kuq(Perxhola),Nr.1, Shk.1, Kati i I-re, tek Liqeni Artificial, Tirane, Shqipëri mund të përpunojë detajet e të dhënave të tij personale të përmendura më sipër për qëllimin e kontaktimit me të përmes postës ose personalisht nga myWorld Albania Shpk , një shoqëri e regjistruar në Bulevardi Bajram Curri, Galeria ETC Business Centre, Kati i 13-të, 1000 Tiranë, me telefon ose me anë të dërgimit automatik të njoftimit (*push notification*) për t'i bërë reklamë Benefit Program ose ofertave të myWorld dhe Kompanisë Partnere.

Anëtari gjithashtu nëpërmjet këtij akti jep pëlqimin e tij - nga i cili mund të heqë dorë në çdo kohë - që informacioni i mëposhtëm mund t'i ofrohet Rekomanduesit të Anëtarit në mënyrë që të informohet në lidhje me Kompanitë e reja Partnere, mundësitë e reja të blerjes ose ofertat speciale: ID-ja e Anëtarit, emri dhe mbiemri, adresa e email-it dhe numri i telefonit.

Anëtari mund të tërheqë pëlqimin(et) e tij (edhe veçmas) me shkrim nga myWorld Albania Shpk, një shoqëri e regjistruar në Bulevardi Bajram Curri, Galeria ETC Business Centre, Kati i 13-të, 1000 Tiranë, Shqipëri ose me email nëpërmjet service.al@myworld.com në çdo kohë me efekt të ardhshëm. Pëlqimi i dhënë në këtë akt për përpunimin e të dhënave personale është i vlefshëm deri kur Anëtari ka tëhequr këtë pëlqim. Nëpërmjet këtyre të dhënave të kontaktit, Anëtari gjithashtu mund të ushtrojë të drejtën e tij për të kërkuar informacion, kryer ndryshime, fshirje, kufizime në lidhje me përpunimin e të dhënave dhe transferimin e tyre.